Kosovo Judicial Institute
Instituti Gjyqësor i Kosovës
Kosovski Institut za Pravosudje

Raporti Vjetor 2005
Instituti Gjyqësor i Kosovës

Hyrje

Gjatë vitit 2005, Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK) ka vazhduar të siguroi trajnim efikas për gjyqësorin dhe organet e ndjekjes në Kosovë me qëllim të zhvillimit të mëtutjeshëm të aftësive profesionale dhe njohurisë juridike të gjyqtarëve dhe prokurorëve Kosovar.

IGJK vazhdimisht e përshtat veprimtarinë e vet trajnuese me ndryshimet, ambientin juridik dhe nevojat e gjyqësorit. IGJK filloi me trajnime të përgjithshme rreth standardeve të drejtave të njeriut dhe ligjeve penale në të mirë të gjithë anëtarëve të gjyqësorit. Më pas IGJK është përqendruar në temat specifike ligjore, siç është e drejta penale, ajo e procedurës penale, e drejta e procedurës civile, dhe e drejta civile, me theks të veçantë në standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut, me qëllim të freskimit dhe azhurnimit të njohurisë juridike të gjyqtarëve dhe prokurorëve.
Shtrirja e veprimtarisë trajnuese të IGJK-së është duke u rritur vazhdimisht, në të njëjtën kohë janë duke u ngritur edhe kompetencat teknike dhe profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Kosovë. IGJK mbështetë zbatimin e standardeve për Kosovën, posaçërisht atë të qasjes së barabartë në drejtësi dhe të drejta pronësore.
Në mënyrë që të arrihen këto qëllime, IGJK ka formuluar orarin e vet në bazë të informatave nga shumë burime të ndryshme. Kryetarët dhe kryeprokurorët nga gjykata dhe prokurori të ndryshme në Kosovë konsultohen rregullisht mbi nevojat e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Pastaj raporte të ndryshme nga Departamenti i Drejtësisë në UNMIK (DD), Departamenti i Administratës Gjyqësore (DAGJ), Sektori për monitorim juridik dhe sektori i të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit në OSBE ngritin çështje të cilat mund të adresohen përmes trajnimit ligjor. Përfundimisht IGJK merr informata drejtpërsëdrejti nga gjyqtarët dhe prokurorët të cilët marrin pjesë në trajnimet e ndryshme përmes marrjes dhe ruajtjes së vlerësimeve të çdo seminari.
Për momentin IGJK është ende pjesë e Sektorit të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit pranë OSBE-së, Sidoqoftë projektligji mbi themelimin e IGJK-së i cili do të themeloi IGJK-në si një institut të pavarur përbrenda strukturës së përgjithshme qeveritare, pritet të miratohet nga Kuvendi i Kosovës në një të ardhme të afërt. Në këtë mënyrë IGJK do të funksionoi si një institut i qëndrueshëm që do të siguroi trajnim fillestar për gjyqtarët dhe prokurorët e ardhshëm, trajnim themelor për gjyqtarët porot, trajnim në rast të promovimit për gjyqtarët dhe prokurorët, si dhe trajnim të vazhdueshëm poashtu për gjyqtarët dhe prokurorët Kosovar.

Veprimtaria e IGJK-së është e ndarë në dy programe kryesore trajnuese të cilat janë: Programi Fillestar dhe i Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor.

I. Programi Fillestar për Arsimim Ligjor (PVAL)

Me vendimin e Këshillit Gjyqësor Prokurorial të Kosovës (KGJPK), IGJK-së në mandatin e vet iu është shtuar edhe një detyrë sfiduese: mbajtja e Programit të parë për arsimim ligjor (PFAL) si një modul para emërimit të kandidatëve për pozita gjyqësore. IGJK në këtë detyrë është ndihmuar nga Agjensioni Evropian për Rindërtim (AER) përmes një projekti të ndihmës teknike të quajtur "Ndërtimi Institucional i IGJK-së". Pilot trajnimi PFAL filloi më 15 prill 2005 dhe vazhdoi deri më 24 qershor 2005. Programi trajnues i PFAL-it u organizua në 15 module, të cilat përfshinin tema relevante nga lëmia civile, penale dhe ushtrime praktike, vizitat në gjykata relevante, institucione, qendra korrektuese dhe stacione policore.
Pas një provimi me shumë konkurrencë të provimit hyrës në gjyqësi, janë zgjedhur 60 kandidatë nga KGJPK për të iu nënshtruar pilot trajnimit të PFAL-it. Ata janë kërkuar që në këtë kurs të marrin pjesë çdo ditë në një periudhë tremujore. Diku përmbi 40 profesionistë të shquar ligjor: prokuror dhe gjyqtar të të gjitha niveleve të gjyqësorit dhe organeve të ndjekjes në Kosovë si dhe juristë, profesor të universitetit janë përfshirë si trajnues në PFAL. Si shtesë në këtë edhe ekspertët ndërkombëtar poashtu kontribuuan në hartimin e doracakëve trajnues, rasteve të shqyrtimit, dhe metodologjisë për këtë program fillestar.
Pas përfundimit të këtij kursi të PFAL-it, 57 nga këta kandidatë kanë treguar rezultat përfundimtar me sukses mbi 50% nga rezultati i përgjithshëm maksimal. Prandaj IGJK ka konsideruar këta kandidatë si të suksesshëm në pjesëmarrjen e tyre dhe përfundimin e PFAL-it.
Sidoqoftë, KGJPK do të bëjë vlerësimin përfundimtar të njohurive dhe shkathtësive profesionale të kandidatëve për pozita gjyqësore. Ky vlerësim do të bëhet përmes rezultateve të intervistave dhe do të bëhen rekomandimet për emërimin e kandidatëve më të suksesshëm për gjyqësinë.

II. Programi i Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor PFAL

Gjatë vitit 2005 nga Programi i Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor (PVAL) u mbajtën 55 (pesëdhjetë e pesë) sesione trajnuese me kohëzgjatje të secilit nga një dhe dy ditë. Numri i përgjithshëm është 1231 (Njëmijë e dyqindetridhjetë e një) ky numër paraqet numrin e përgjithshëm të pjesëmarrësve sepse shumica e gjyqtarëve dhe prokurorëve në vitin 2005 morën pjesë nga tri deri në pesë sesione për një vit.

II.1. Seminare dhe Tryeza të diskutimeve nga lëmia penale

Këtu janë përfshirë seminare dhe tryeza të diskutimeve nga Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, Ligji Penal për të Mitur i Kosovës, Rregullorja mbi Procedurën Penale ku përfshihen Kryerës me çrregullime mendore, Rregullorja e parandalimit të pastrimit së Parave dhe veprave tjera të ngjashme.

Gjatë dy viteve të fundit trajnimi rreth kodeve të reja penale dhe akteve tjera ligjore ishte prioritet. Sesionet trajnuese u përqendruan në aplikimin normave materiale dhe procedurale sipas sistemit në kodet e reja.
Gjatë tërë vitit, IGJK ofroi gjithsej 23 (Njëzetetre) sesione trajnuese. Në vazhdën e këtyre veprimtarive janë trajtuar shumë fusha dhe specifika të cilat kanë qenë të ndërlidhura me dispozitat e reja penale, llojet e dënimeve dhe procedurat e reja. Risitë e prezantuara në kodet e reja janë trajtuar në përgjithësi sikurse edhe shumë çështje tjera me vlerë të cilat janë të ndërlidhura me zbatimin e standardeve ndërkombëtare që kërkohen nga sistemi i ri gjyqësor në Kosovë.

Përmes këtyre veprimtarive janë shtjelluar temat në vijim: këqyrja e vendit të ngjarjes dhe rikonstruimi i vendit të ngjarjes, ekspertiza gjyqësore dhe dhënia e urdhrit për ekspertim roli, struktura dhe pozita e krim teknikes, procedura gjatë konfirmimit të aktakuzës, paraburgimi, caktimi dhe vazhdimi i paraburgimit, vazhdimi i paraburgimit gjatë procedurës paraprake, pas ngritjes së aktakuzës dhe para ngritjes së Aktakuzës, caktimi dhe vazhdimi i paraburgimit pas shpalljes së Aktgjykimit. Një nga temat e shtjelluara ishte poashtu edhe paraburgimi për personat më çrregullime mendore dhe procedura në rastin e paaftësisë për t'ju nënshtruar gjykimit, kryerësit e veprave penale me çrregullime mendore dhe aftësi të zvogëluar mendore. Trajnimet përfshinë edhe sëmundjet që shkaktojnë paaftësinë mendore dhe aftësinë e zvogëluar mendore, procedura në rastet e paaftësisë mendore dhe aftësisë së zvogëluar mendore në kohën e kryerjes së veprës penale, shqiptimi i masave dhe sanksioneve ndaj kryerësve me çrregullime mendore dhe aftësi të zvogëluar mendore, vendimet gjyqësore, rishqyrtimi dhe pushimi i trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, shqyrtimi kryesor, caktimi dhe vazhdimi i paraburgimit pas komunikimit të aktgjykimit dhe përpilimi i aktgjykimit.
Një nga temat e reja për trajnim ishte procedura e ankimit: ankesa si mjet i rregullt juridik, e drejta për ushtrimin e ankesës, afati dhe subjektet ankimore, bazat ankimore.

IGJK organizoi seminar mbi luftimin e trafikimit me qenie njerëzore me theks të veçantë në mbrojtjen e viktimave, dhe praktikën përkatëse gjyqësore në gjykatat në Kosovë. Një sesion i ndarë trajnues u përqëndrua në mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave gjatë procedurës penale është organizuar në shtator të vitit 2005.

Një nga seminaret më të suksesshme ishte ai për krimet e luftës i mbajtur në qershor. Ky trajnim u përqendrua në legjislacionin përkatës në Kosovë rreth krimeve të luftës, praktika gjyqësore nga Tribunali i Hagës dhe bashkëpunimi me gjykatat në Kosovë, pranueshmëria e dëshmive në Tribunal, dënimet sipas ligjit dhe, hetimet e krimeve të luftës.

IGJK gjithashtu ka zgjeruar mbajtjen e trajnimeve në formë të tryezave duke u përpjekur të përfshijë të gjitha rajonet e Kosovës. Këto tryeza janë mbajtur në të gjitha rajonet e Kosovës nga janari gjerë në fund të dhjetorit 2005 duke shtjelluar dispozitat e reja të ligjeve penale. Gjyqtarët dhe prokurorët kanë shprehur interesim për trajnime që janë organizuar në rajonet e tyre dhe kjo për arsye të dilemave me të cilat ata ballafaqohen në praktikën e tyre të përgjithshme gjatë aplikimit të këtyre ligjeve dhe për shkak të kohës së shkurtër të aplikimit të këtyre kodeve të reja, ende nuk është krijuar një praktikë e nevojshme gjyqësore me ligjet e nxjerrura rishtazi.
Këto tryeza të diskutimeve janë mbajtur për gjyqtarët dhe prokurorët të cilët kanë shprehur nevojën për të shtjelluar bashkërisht dhe për të eliminuar dilemat rreth kodeve të nxjerra rishtazi.

IGJK ka kushtuar rëndësi të veçantë kërkesave për trajnime shtesë mbi bashkëpunimin në procedurën paraprake. Ky seminar tregoi se kjo është mënyra e duhur për përmirësim të bashkëpunimit dhe bashkëpunimit profesional në mes të policisë, prokurorit dhe gjykatës në fazën paraprake të procedurës penale.

Gjatë vitit 2005 IGJK vazhdoi me organizimin e punëtorive në bashkëpunim me Shoqatën e gjyqtarëve, atë të prokurorëve dhe Odën e avokatëve të Kosovës. Këto tri organizata profesionale gjatë vitit 2004 kanë marrë një iniciativë për organizimin e sesioneve trajnuese në të gjitha rajonet e Kosovës duke u përqendruar në eliminimin e dilemave në aplikimin e Kodit Penal, atij të Procedurës Penale si dhe ligjeve dhe Rregulloreve të lartpërmendura.

Këto trajnime kanë qenë të orientuara kah praktika dhe shumë interaktive me shumë raste të studimit dhe imitime të gjykimeve. Gjatë debateve në sesionet e organizuara gjyqtarët dhe prokurorët kanë qenë të ftuar të diskutojnë rreth një rasti të vërtet nga praktika gjyqësore, i cili rast, demonstronte dilemat dhe vështirësitë gjatë aplikimit të kodeve të reja penale.

Qëllimi i këtyre debateve dhe diskutimeve në tryeza, si në regjione ashtu edhe në IGJK, ka qenë të arrihet standardizimi në interpretim dhe zbatimi i dispozitave ligjore dhe të ofrohet ndihmë përkitazi më harmonizimin e qëndrimeve në të mirë të praktikes gjyqësore duke ju referuar dispozitave të cilat paraqesin dilema dhe vështirësi gjatë aplikimit në praktik.

Rezultati i këtyre diskutimeve dhe debateve të frytshme ka qenë se janë nxjerr disa qëndrime të përbashkëta. Është parim themelor sidoqoftë, që këto qëndrime përkatëse dhe

udhëzime nuk mund të jenë obligative për gjykatat dhe secili gjyqtar dhe prokuror është plotësisht i pavarur në vendosjen rreth rasteve.

Në këto sesione trajnuese morën pjesë ekspert vendorë dhe ndërkombëtarë, pra në seminare dhe tryeza kanë marrë pjesë (4) gjyqtarë dhe (2) prokurorë ndërkombëtar, ekspert dhe këshilltar ligjor nga OSCE/OSBE, QKGJSH/ NCSC, ICTY/ICTR, Divizioni penal i UNMIK DD/, UNICEF, Shërbimi Sprovues i Kosovës si dhe organe dhe institucione tjera.

Gjatë këtyre sesioneve, ata kanë dhënë kontributin dhe rekomandimet e tyre profesionale shumë të mirëpritura dhe ato janë vlerësuar si mjaft të suksesshme si nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve vendor ashtu edhe nga ana e trajnuesve – ekspertëve të IGJK – së.

IGJK ka organizuar edhe seminare shumë specifike në bashkëpunim me subjektet e lartpërmendura, më gjyqtar dhe prokuror ndërkombëtar përkitazi më çështjet e krimit të organizuar, krimeve të luftës, trafikimit me qenie njerëzore, mbrojtjes kundër dhunës në familje, aspekteve të përgjithshme dhe konkrete rreth aplikimit të dispozitave të ligjit kundër diskriminimit, ndihmës juridike ndërkombëtare, bashkëpunimit ndërkombëtar gjyqësor, ekzekutimit të sanksioneve penale, llojeve të ndryshme të dënimeve dhe sanksioneve etj.

IGJK ka ofruar edhe 4 (katër) sesione trajnuese për gjyqtarët e gjykatave për kundërvajtje. Këto sesione janë mbajtur sipas programit të trajnimeve me tema përkatëse të kundërvajtjeve, që janë mirëpritur nga ana e gjyqtarëve të gjykatave për kundërvajtje.

Temat e trajnimit për këto seminare janë përpiluar nga gjyqtarët që punojnë në Gjykatën e lartë për kundërvajtje të Kosovës. Qëllimi ka qenë që çdo gjyqtari për kundërvajtje të iu ofrohet mundësia të ngritin diturinë e tyre në aplikimin e risive në sistemin gjyqësor të Kosovës.

II. 2 Seminare dhe Tryeza të diskutimeve nga lëmia civile

Gjatë vitit 2005 IGJK ka organizuar sesione të ndryshme trajnuese nga lëmia civile si pjesë e Programit të Vazhdueshëm ligjor. Tryezat dhe seminaret e ndryshme u përqendruan në legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë ndryshimet në të drejtën civile dhe atë të procedurës civile. Sikurse edhe më parë qëllimi i trajnimit ishte harmonizimi i praktikës gjyqësore.
Qëllimi kryesor i Institutit Gjyqësor të Kosovës është që të mbuloi sa më shumë çështje të ndryshme ligjore që është e mundur dhe të përfshijë gjyqtarët të cilët punojnë në fusha specifike.

IGJK ka organizuar sesione trajnimi rreth: Ligji mbi trashëgiminë, ligji mbi marrëdhëniet e punës, rregullorja mbi mbrojtjen kundër dhunës në familje, ligji kadastral dhe ligji mbi hipotekën, të drejtat pronësore, eksproprijimi dhe kompensimi, privatizimi, ligji mbi marrëdhëniet familjare dhe martesore, ligji mbi procedurën kontestimore, jashtëkontestimore dhe përmbarimore, ligji mbi marrëdhëniet detyrimore dhe rregullore të ndryshme si ajo për shitjen e mallrave etj.

Lidhur me këtë komponent të trajnimeve IGJK, ka ofruar tema konkrete në sesionet e organizuara në seminare dhe tryeza në 5 rajonet e Kosovës. Në këto sesione janë shtjelluar tema prioritare përkitazi me të drejtën pronësore dhe të drejtat tjera të parapara në të drejtën civile të gjitha këto në frymën e respektimit të drejtave pronësore të cilat sipas konventave evropiane janë të drejta të pa tjetërsueshme të njeriut. Trajnimet janë përqendruar në unifikimin dhe përshtatjen e praktikës tonë gjyqësore shteteve me praktik të avancuar në drejtim të mbrojtjes ligjore të këtyre të drejtave themelore.

Të gjitha sesionet trajnuese u mbajtën në forma të debateve interaktive të përcjella me raste të studimit nga praktika gjyqësore. Sesionet u mbajtën në të gjitha rajonet e Kosovës.

Pas miratimit të ndryshimeve nga KGJPK të bëra në Kodet e Etikës dhe mirësjelljes profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve dhe gjyqtarëve porot rëndësi e veçantë i është kushtuar trajnimit rreth etikës gjyqësore për gjyqtarët dhe prokurorët në Kosovë. IGJK në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare për Gjykatat Shtetërore / NCSC/ nga SHBA në qershor të vitit 2005 ka organizuar 12 sesione trajnuese mbi etikën, pavarësinë dhe sjelljen profesionale të gjyqësorit të Kosovës. Këto veprimtari dhe ky bashkëpunim do të vazhdoi edhe në të ardhmen, duke pasur parasysh që etika dhe sjellja profesionale e gjyqtarit dhe prokurorit është shumë me rëndësi për punën e suksesshme në përditshmërinë gjyqësorit. Temat e shtjelluara janë përqendruar në përgjegjësitë përkitazi më ndryshimet më të reja të kodeve të etikës dhe sjelljes profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilat kanë hyrë tani në fuqi.
Prandaj gjatë këtyre 12 sesioneve trajnuese të organizuara në këtë fushë janë angazhuar trajnues vendor dhe një trajnues ndërkombëtar – gjyqtar ndërkombëtar me përvojë shumë të gjatë nga kjo lëmi.

Ky bashkëpunim i frytshëm me NCSC –në pritet të zgjerohet edhe në trajnimin e përbashkët rreth administrimit të gjykatave dhe udhëheqjes së rasteve.

IGJK në bashkëpunim me KGJPK-në organizoi edhe një sesion trajnues në tetor duke u përqendruar në Etikën Gjyqësore me theks të veçantë në sjelljen profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve, procedurat disiplinore pranë këshillit si dhe roli dhe kompetencat e Njësisë për Inspektime Gjyqësore.

II. 3 Trajnimi për Gjyqtarët Porot

Në mars të vitit 2005 IGJK filloi ciklin e trajnimeve fillestare për gjyqtarët porot të cilat janë mbajtur në pesë rajonet e Kosovës. Programi fillestar i trajnimit ka për qëllim të siguroi një vështrim të përgjithshëm në funksionin dhe përgjegjësitë e gjyqtarëve porot në procedurën penale dhe civile si dhe në aspekte kryesore mbi etikën e pozitës së gjyqtarit porot.

II. 4 Trajnim nga e Drejta e Bashkimit Evropian

Në dhjetor të vitit 2005 IGJK organizoi seminarin e parë dy ditor nga e Drejtë e Bashkimit Evropian (e Drejta e BE-së). Gjatë PFAL-it programi trajnues përmbante disa tema nga e drejta e BE-së dhe pas një reagimi shumë pozitiv, IGJK vendosi të përfshijë këtë trajnim në programin e vet trajnues. Qëllimi i këtij trajnimi është që të prezantoi parimet themelore dhe institucionet themelore të BE-së, specifikat e sistemit juridik dhe procedurat, aktet e ndryshme juridike dhe rëndësinë përfshirjes së këtyre normave juridike në legjislacionin vendor të Kosovës. Instituti është duke planifikuar që edhe më tej të zhvilloi dhe zgjeroi përmbajtjen e këtij programi trajnues.

II.5 Trajnimet për Trajnuesit

II.5.1

Në nëntor të vitit 2004 Këshilli i Evropës (KE) në bashkëpunim me IGJK-në ka organizuar programin e parë të specializuar për gjyqtarët dhe prokurorët Kosovar si dhe trajnuesit gjyqësor rreth Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut në Strasburg të Francës. Janë finalizuar kurset trajnuese për këtë vit. Gjatë kësaj periudhe kohore në IGJK janë mbajtur 7 sesione trajnuese. Disa ekspert nga Departamenti i të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit në OSBE janë angazhuar nga Këshilli i Evropës si dhe ekspertë tjerë të KE-së në mënyrë që të mbajnë trajnim në fushën e ligjeve të aplikueshme dhe konventave të cilat rregullojnë çështjen e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Në këtë trajnim morën pjesë grupi prej 18 (tetëmbëdhjetë) pjesëmarrësve për ciklin e parë dhe 20 (njëzet) për ciklin e dytë të mbajtur në vjeshtë të vitit 2005 që përbëheshin nga gjyqtarë dhe prokurorë nga të gjitha rajonet e Kosovës të cilët vijnë nga të gjitha nivelet e gjykatave të Kosovës si ajo supreme të qarkut dhe komunale si dhe prokuroritë komunale dhe të qarkut. Poashtu edhe personeli trajnues i IGJK-së mori pjesë në këtë trajnim.
Programi i lartpërmendur është përqendruar kryesisht në metodat speciale të avancuara. Qëllimi ishte që të ngritët dituria juridike e ekspertëve dhe aftësitë e tyre praktike që do të u mundësojnë atyre të mbajnë sesione trajnuese në çështjet e të drejtave të njeriut duke aplikuar metodologjinë e mësuar gjatë këtyre sesioneve.

Qëllimi i kësaj veprimtarie trajnuese ishte që të trajnoi një grup të ekspertëve se si të mbajnë prezantime dhe raste praktike të studimit gjatë trajnimeve, hartim të programeve trajnuese hartim të rasteve të prezantuara sipas standardeve Evropiane dhe mekanizmave të drejtave të njeriut. Pas mbajtjes së sesioneve trajnuese kandidatët u testuan.

II.5.2

Si pjesë e rëndësishme e strategjisë trajnuese, në dhjetor të vitit 2005 instituti organizoi dy trajnime të specializuara për trajnues në Ohër të IRJM-së. Grupi i parë prej 18 (tetëmbëdhjetë) pjesëmarrësve iu nënshtrua nivelit themelor të trajnimit TIT dhe i dyti nivelit të avancuar të TIT.
Dy trajnues gjyqësor ndërkombëtar e mbajtën këtë program trajnues.

Ideja prapa një trajnimi të tillë të trajnuesve është që trajnuesit të përmirësojnë shkathtësitë e tyre të mbajtjes së trajnimeve, duke zbatuar metodologjinë moderne për trajnimin e madhorëve. Ata kanë nevojë që edhe më tej të zhvillojnë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre praktike.
Përzgjedhja e pjesëmarrësve u bë në bazë të paraqitjes së tyre gjatë Programit Fillestar për Arsimim Ligjor, pjesëmarrjes në Programet e mëparshme të TIT-it shkathtësive profesionale dhe kualiteteve personale.
Përfundimi i këtyre dy sesioneve të TIT-it kontribuon në përmbushjen e strategjisë afatgjatë trajnuese të IGJK-së që është: themelimi i një ekipi të trajnuesve me përvojë, të specializuar në mbajtjen e trajnimit të fillestar dhe të vazhdueshëm i cili do të jenë në gjendje të plotësojnë nevojat në rritje e sipër të gjyqësorit të Kosovës sa i përket kualitetit të trajnimit.

III. Vlerësimi i nevojave të trajnimit gjyqësor

Gjatë vitit 2005 IGJK për herë të parë ka përdorur metodën e re për organizimin e vlerësimit të nevojave të gjyqësorit (VNGJ) në mënyrë që të sigurohet përgatitja e një programi të trajnimit i cili është i qëndrueshëm, i zbatueshëm dhe i orientuar kah praktika i cili mbulon jo vetëm nevojat e menjëhershme të gjyqësorit dhe organeve të ndjekjes në Kosovë por edhe prioritetet afatgjata të cilat janë të ndërlidhura për së afërmi me procesin e vazhdueshëm të drejtësisë, tranzicionit dhe reformës gjyqësore në Kosovë.
Formularët e vlerësimit të mbushura nga pjesëmarrësit në ngjarje të ndryshme trajnuese u dëshmuan si një formë shumë efikase dhe adekuate për vlerësimin e nevojave të gjyqësorit në Kosovë. Prandaj menaxhmenti i programit i IGJK-së vendosi që edhe më shumë të shtjelloj këtë duke përdorur metodën e drejtpërdrejtë të mbledhjes së vlerësimeve dhe informatave për nevojat e sakta të trajnimeve për gjyqësorin në Kosovë dhe si rrjedhojë ka lansuar një metodë të tillë të vlerësimit. VNGJ përbëhet nga disa komponentë dhe ka për qëllim të prek aspekte të ndryshme të nevojave për trajnime gjyqësore.

Si komponentë e parë IGJK ka përdorur praktikën e zakonshme të mbajtjes së takimeve të rregullta me kontakt personat. Kontakt personat e IGJK-së janë kryetarët e pesë gjykatave të qarkut. Ata jo vetëm që shërbejnë si persona kontaktues për gjithë korrespondencën, materialet, informatat relevante, shkëmbimin në mes të IGJK-së dhe Gjykatave por janë poashtu edhe këshilltar *ad hoc* të IGJK-së në përpilimin e programeve më të rëndësishme, legjislacionit, trajnimit i cili ndërlidhet me çështjet tjera profesionale.
Gjatë një diskutimi të mbajtur në fillim të nëntorit 2005 kontakt personat mirëpritën idenë dhe sugjeruan që IGJK të luaj një rol më aktiv në kontaktimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Takimet me gjyqtarët dhe prokurorët diskutimet dhe vizitat nëpër gjykata ishin format e sugjeruara të bashkëpunimit të ngushtë. Kontakt personat poashtu mirëpritën idenë e bashkëdrejtueses ndërkombëtare për shpërndarjen e pyetësorëve për vlerësimin e nevojave të trajnimit dhe për organizimin e një VNGJ të përshtatshme. Personeli menaxhues i programit në IGJK mori vendim për zhvillimin e një programi vjetor të IGJK-së për vitin 2006 si dhe një strategjie afatgjatë për vitet e ardhshme duke i vështruar kështu se cilat janë nevojat e sakta të trajnimit të gjyqësorit të Kosovës.

Si komponentë e dytë e VNGJ-së, IGJK zhvilloi një pyetësor me qëllim që të vështroi kualitetin e trajnimeve të mbajtura në vitin 2005 dhe të marr mendimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve përkitazi me hapat e nevojshëm që duhet ndërmarrë nga IGJK drejt zhvillimit të programit vjetor të trajnimit për vitin 2006. Pyetësorët iu janë shpërndarë të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në Kosovë me qëllim të kërkimit të mendimit të tyre për veprimtaritë e kaluara trajnuese dhe për të kërkuar propozime për temat e ardhshme, metodologjinë dhe orarin e trajnimeve që do të organizohen në të ardhmen nga IGJK.

Si komponentë e tretë e hulumtimit të vlerësimit të nevojave të trajnimit personeli i programit të IGJK-së mbajti trajnime me gjyqtarët dhe prokurorët në pesë rajonet e Kosovës. Një takim i ndarë u mbajt me kryetarin e Gjykatës së lartë për kundërvajtje, dhe me disa nga kryetarët e gjykatave komunale për kundërvajtje. Gjatë këtyre takimeve personeli i programit i IGJK-së diskutoi me gjyqtarët rreth planeve dhe propozimeve të tyre dhe për futjen e trajnimeve të ardhshme në Programin vjetor të trajnimit për vitin 2006. Takimet u mbajtën në mes të datave 7 dhe 18 nëntor 2005 në pesë gjykatat e qarkut. Gjyqtarët dhe prokurorët që ishin prezent u kërkuan që të paraqesin rekomandimet e tyre, shënimet dhe vërejtjet për organizimin e trajnimit të IGJK-së.

Menaxhmenti i IGJK-së poashtu pati takime edhe me kryetarin e gjykatës supreme në mënyrë që të diskutoi mbi rolin dhe përfshirjen në të ardhmen të gjykatës supreme në trajnime. Pyetësori i VNGJ iu shpërnda gjyqtarëve edhe në këtë gjykatë.
Nga vlerësimi i përgjithshëm do të përpilohet një raport i ndarë nga menaxhmenti i IGJK-së.

Këto janë gjërat më të rëndësishme dhe rekomandimet e mbledhura:

- vlerësimi i përgjithshëm tregon një vlerësim të lartë të organizimit dhe kualitetit të trajnimeve të IGJK-së. Rezultatet konfirmojnë faktin e njohur deri më tani se të gjithë gjyqtarët kanë qasje të barabartë në krahasim me prokurorët.
- Shumica e gjyqtarëve i shohin trajnimet e mbajtura në IGJK si relevante dhe të dobishme në një masë të madhe për punën e tyre të përditshme.
- Shumica e gjyqtarëve janë të kënaqur me paraqitjen e trajnimeve të IGJK-së nga ekspertët
- Shumica e gjyqtarëve dhe prokurorëve preferojnë të trajnohen në Prishtinë. Ka edhe një numër të rekomandimeve për trajnime në terren. Në fakt rezultati mbështet qasjen që IGJK e ka përvesuar në fillim të vitit 2004 i cili bën më shumë trajnime në terren.
- VNGJ tregoi se kohëzgjatja e kurseve trajnuese është e mjaftueshme. Shumica e pjesëmarrësve preferojnë që trajnimi të zgjasë një apo dy ditë.
- Shumica e gjyqtarëve dhe prokurorëve preferojnë trajnimet që janë më fleksibile dhe më interaktive në vend të atyre klasike të ligjërimit. Ngjarjet trajnuese në formë të diskutimeve në tryezë të rrumbullakët janë absolutisht më të favorizuara
- VNGJ poashtu konfirmoi profilin e masës e cila trajnohet. Shumica e gjyqtarëve dhe prokurorëve (142 gjyqtar dhe 12 prokuror nga numri total janë 175 gjyqtarë dhe 25 prokurorë të cilët e kanë plotësuar pyetësorin) kanë më shumë se shtatë vjet përvojë profesionale.
- Kjo është arsyeja përse shumica e anëtarëve të gjyqësorit të cilët iu kanë përgjigjur pyetësorit preferojnë që të kenë trajnim i cili përqendrohet në problemet praktike të cilat dalin nga ligji i aplikueshëm në Kosovë dhe legjislacioni i ri në vend të trajnimit i cili orientohet në zhvillimin e shkathtësive të tyre profesionale (trajnim për udhëheqjen e rasteve arsyetimi juridik dhe hartimi). Një numër mjaft i madh i gjyqtareve kanë shprehur dëshirën që të kenë trajnim për të drejtat e njeriut dhe trajnim për të drejtën ndërkombëtare dhe atë të bashkimit evropian.
- Vlerësimi i rezultateve të VNGJ-së është bazë për zhvillimin e programit të vazhdueshëm trajnues të IGJK-së për vitin 2006. Kalendari trajnues do të mbuloi fushat më të preferuara dhe temat e rekomanduara. VNGJ mund të shfrytëzohet si një burim afatgjatë i informatave për IGJK-në dhe çdo organizatë tjetër e cila merret me trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

IV. Planet e Trajnimit të IGJK-së për vitin 2006.

PVAL

Viti i ardhshëm do të ketë një rëndësi të veçantë për zhvillimin e IGJK-së. Instituti pritet të bëhet një institut i pavarur vendor i cili për momentin është duke u ballafaquar me sfidat dhe pengesat e periudhës tranzicionale dhe ndryshimet të cilat priten të bëhen. Në të njëjtën kohë veprimtaria trajnuese duhet të mbahet në përputhshmëri me planifikimin paraprak. Menagjmenti i IGJK-së dhe personeli i trajnimeve po punojnë në zbatimin e një sistemi të ri i cili quhet sistemi i aplikimit për trajnime në vend të sistemit të dërgimit të ftesave që ka qenë më parë. Sistemi i aplikimit parasheh një rol proaktiv për gjyqtarët dhe prokurorët ku ata do të aplikojnë për ngjarjet trajnuese për të cilat janë të interesuar në vend se kjo iniciativë t'i lihet institutit që ai të përzgjedhë pjesëmarrësit për ngjarjet trajnuese. Sistemi i aplikimit është sistem i cili është shumë i përdorur nëpër institucionet e trajnimeve gjyqësore në tërë botën dhe besohet të jetë sistemi shumë efikas.
Me këtë iu jepet mundësia gjyqtarëve dhe prokurorëve që të hartojnë orarin e vet të trajnimit në përputhshmëri me interesat e tyre profesionale dhe nevojat e tyre të sakta trajnuese. Pasi të jetë prezantuar një sistem i tillë do të jetë sistemi më i leverdishëm edhe për IGJK-në. Ky sistem do të mundësoi IGJK-në që më mirë të planifikoi veprimtaritë e veta trajnuese dhe të përcjellë interesat e sakta të trajnimit profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve.
Sistemi i aplikimit parasheh që pasi gjyqtarët dhe prokurorët ta kenë pranuar programin vjetor të IGJK-së dhe kalendarin për çdo tremujor ata të aplikojnë paraprakisht për sesionet e preferuara trajnuese. Pas përfundimit të afateve për aplikim personeli i IGJK-së do të përgatis listën përfundimtare të pjesëmarrësve të cilët do të marrin pjesë në trajnim.
Në bazë të VNGJ-së dhe rekomandimeve të dhëna IGJK do të luaj një rol më aktiv në organizimin e ngjarjeve të ndryshme trajnuese në fushat përkatëse. Gjatë takimeve të mbajtura nëpër rajone është ardhur në pajtim që Instituti të organizoi punëtori (një nga lëmia penale dhe një nga lëmia civile) për çdo tremujor nëpër çdo rajon. Së bashku me kurset e rregullta trajnuese, të cilat do të japin një mundësi më të madhe çdo gjyqtari dhe prokurori që të marrë pjesë në trajnim për të cilin ai/ajo është i /e interesuar. IGJK duhet të rrisë rolin e vet si një institut për këshillime dhe hulumtime i cili do të asiston dhe kontribuon në përpjekjet e vazhdueshme të komunitetit juridik drejt nxjerrjes dhe shpërndarjes së më shumë materialeve ligjore të cilat analizojnë legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë dhe mundësojnë qasje në edhe në rastet dhe praktikën aktuale gjyqësore.

IGJK ka bërë hapin e vet të parë dhe shumë të rëndësishëm në publikim e përmbledhjes së parë në tri gjuhët zyrtare të disa materialeve trajnuese të mbledhura gjatë vitit. Instituti planifikon që edhe më tej të zhvillon veprimtarinë e vet në këtë drejtim.
Në përputhshmëri me kërkesat e anëtarëve të gjyqësorit të Kosovës, IGJK do të shtjelloi edhe programin e vet vjetor të trajnimit të vazhdueshëm. Programi për tremujorin e parë të vitit 2006 tashmë është shpërndarë në fillim të dhjetorit. Pritet që Programi vjetor i vitit 2006 të jetë i gatshëm deri kah fundi i dhjetorit 2005. IGJK duhet të qëndroi fleksibil ndaj nevojave tjera për trajnim të cilat do të dalin nga legjislacioni i ri apo ristrukturimi i Sistemit Gjyqësor në Kosovë.

PFAL

Sipas projektligjit për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, pas miratimit të tij PFAL-i do të zgjasë 12 muaj. Dhjetë muaj do të jenë me trajnim intensiv në IGJK dhe dy muaj tjerë do të jenë trajnim praktik në gjykatat/prokuroritë përkatëse. Një zgjatje e tillë kohore e veprimtarisë së IGJK-së do të kërkoi një angazhim të madh të burimeve trajnuese si dhe specializim të mëtejmë të programit trajnues, Prandaj IGJK do të duhet të ketë para sysh zhvillimin e programit trajnues për periudhën 10 mujore dhe duhet të përshtat atë me nevojat e posaçme të gjyqtarëve dhe të prokurorëve.
Caktimi i trajnuesve do të merret në konsideratë përshtatshmërisht. Për momentin IGJK është duke përdorur kryesisht trajnues të jashtëm – të gjithë gjyqtar dhe prokuror. Pasi që PFAL-i të ndahet në PFAL të prokurorëve dhe në atë të gjyqtarëve do të mund të ketë nevojë për krijimin e ekipeve të trajnuesve, të cilët do të jenë të përkushtuar ndaj trajnimit njëherë vetëm të gjyqtarëve, ose vetëm të prokurorëve. Nëse kemi nja metodë të tillë të ndarjes kjo do të sillte një specializim dhe zhvillim të mëtutjeshëm të programeve trajnuese dhe të metodologjive trajnuese të trajnuesve.

Trajnim i Trajnuesve

IGJK do të përqendrohet në ndërtimin e kapaciteteve dhe në përzgjedhjen e një ekipi të trajnuesve vendor të cilët do të kenë aftësi që në të ardhmen të marrin përgjegjësinë për mbajtjen e kurseve të TIT-it për trajnuesit e ardhshëm gjyqësor.

V. Konkluzion

Viti 2005 mund të konsiderohet si një vit shumë i suksesshëm për IGJK-në. Përvoja e fituar në përgatitjen dhe mbajtjen e veprimtarive të shumëllojshme tregon potencialin serioz që ka Instituti dhe qasjen fleksibile ndaj nevojave dhe kërkesave të gjyqësorit në vend. Në të njëjtën kohë ekzistojnë shumë hapa të rëndësishëm që duhet të ndërmerren si: forcimi i

personelit trajnues të IGJK-së, themelimi i një administrate funksionale dhe moderne dhe kryesisht emërimi dhe ndërtimi i kapaciteteve të personelit menaxhues të Institutit. Dhe së fundi ekzistojnë disa rregullore të rëndësishme dhe dokumente tjera juridike të cilat duhen nxjerrur, shqyrtuar dhe zbatuar. Nxjerrja e tyre do të siguronte funksionim të mirëfilltë të IGJK-së në të ardhmen në përputhshmëri me rregullat e aplikueshme, procedurat dhe kërkesat ligjore.